



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Televizioni "Dukagjini" Sh.p.k.
Pronar – z. Ekrem LLUKA
RADIO DUKAGJINI
Rr/Ismajl Qemajli, nr. 2
Pejë

Ref: 1703/300/LIC/ni

VENDIM

lidhur me miratimin e kërkesës për frekuencë shtesë (105.0 MHz) Radio Dukagjinit, për transmetim nga lokacioni brenda zonës së Duhlës, i vendosur zyrtarisht me seli në Pejë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e tyre në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Dukagjini është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio i cili i përket kategorisë me mbulim nacional për të transmetuar programe në territorin e Republikës së Kosovës. Më datë 28 gusht 2016, Radio Dukagjini iu është vazhduar licenca e transmetimit nga KPM.
3. Më datën 22 mars 2017, Radio Dukagjini ka dorëzuar një kërkesë në KPM, me anë të së cilës ka kërkuar edhe një frekuencë shtesë për transmetim nga lokacioni në zonën e Duhlës, të komunës së Therandës, me qëllim të zgjerimit të mbulimit me sinjal radio.
4. Në kërkesës e parashtruar nga Radio Dukagjini, janë ofruar edhe detajet teknike si dhe koordinatat e sakta të vendndodhjes së sistemit të transmetimit.
5. Më datë 22 mars 2017, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) pranë Zyrës Ekzekutive ka bërë matjet teknike në teren për të vlerësuar parametrat teknike dhe mundësitë për gjetjen e një frekuence të lirë në lokacionin e propozuar me anë të kërkesës.

Arsyetimi


6. Kërkesa e Radio Dukagjinit për frekuencë shtesë të transmetimit, mbështetet në qëllimin e sajë për krijimin e rrjetit të vetë të transmetimit, në mënyrë që të mbuloj sa më shumë territor të Republikës së Kosovës, me theks të veçantë, pjesën e autostradës në atë zonë.
7. Kërkesa e Radio Dukagjinit është në pajtim me kategorinë e këtij subjekti të licencuar.
8. Rezultatet e matjeve të bëra nga DMF, të datës 22 mars 2017, tregojnë se frekuenca 105.0 MHz në koordinatat *N42°25'7.34" dhe E 20 °53'33.08"*, me lartësi mbidetare 870 metra në lokacionin *Duhël*, është frekuencë e lirë, e pa interferuar, në pajtim me Planin Frekuencor dhe si e tillë mund të jipet në shfrytëzim për zgjerim të mbulimit me sinjal radio.
9. Në pajtim me nenin 16, paragrafi 1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni konstaton se, kërkesa për frekuncë shtesë të transmetimit të Radio Dukagjini është e bazuar dhe në pajtueshmëri me Kushtet dhe Ternet e Licencës KPM-së, dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim nga ana Komisionit.

Vendim

10. Komisioni në takimin e mbajtur më datën 14 prill 2017, merr vendim që, Radio Dukagjinit t'ia aprovojë kërkesën për frekuncë shtesë për transmetim në frekuencën 105.0 MHz, sipas kërkesës së tyre dhe në pajtim me parametrat teknik të verifikuara edhe nga DMF.

Lëshimi i Vendimit

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



14.04.2017
datë

300,

Lloji i dërgesës
Vista postiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznaçona vrednost - poslani iznos

nën numër
pod broj
EKREM JLUCA / RAJDO DUKAGJANI
për
za RR/ ISMAËL QEMAJLI NR. 2
Vendi
(Mesto) PEËË

Posthtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë)
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena gotovo)

02/06/17

Nënshkrimi i nënpunësit të postës së vendit
Potpis ratnika pošte

Vula e postës së vendit
Peçat pošte



Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca

[Signature]

[Signature]